



## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

*(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)*

**Drejtuar:** **BOE - “EVOLVE ENGINEERING” sh.p.k., me NIPT M01910016I**  
Adresa: Tiranë, Rruga “Don Bosko”, Objekt Shërbimi Nr. 7, Nr. pasurie 9/438-N7.  
**- “EPES GROUP” sh.p.k., me NIPT L22320017F**  
Adresa: Tiranë, Njesia Administrative Nr. 7, Rruga “Artan Lenja”,  
Ish fusha e Aviacionit, Kati parë, Pasuria me numër 2/885, Volumi 52, Faqe 68, ZK. 8220.

**Procedura e prokurimit:** “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Mallra.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-54937-12-23-2022

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje pajisjesh sekondare për mirëmbajtjen e Nënstacioneve”.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike Data 30.12.2022, Nr. 179.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. OE “NOVAMAT” sh.p.k. me NIPT K81615002O**  
Vlera 64,370,000 (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
- 2. BOE “EVOLVE ENGINEERING” sh.p.k. me NIPT M01910016I**  
**“EPES GROUP” sh.p.k. me NIPT L22320017F**

Vlera 68,456,000 (gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH.

**3. OE “LIGUS” sh.p.k.,**

**me NIPT L51523001S**

Vlera 69,406,000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. OE “NOVAMAT” sh.p.k., me NIPT K81615002O, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, dhe konkretisht për Aksesorë për analizatorët e gazeve të autotransformatorëve dhe transformatorëve.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur katalogun e prodhuesit për mallin objekt prokurimi, dhe konkretisht për Aksesorë për analizatorët e gazeve të autotransformatorëve dhe transformatorëve.

Referuar katalogjëve dhe informacionit teknik të ofruar nga OE “Novamat” sh.p.k., janë konstatuar mangësi thelbësore teknike lidhur me mallrat e ofruara, si më poshtë vijon:

- Lidhur me mallrat “Furnizimin mbrojtje distancionale”, OE, si katalog ka paraqitur një dokument konfigurimi i releve lëshuar nga prodhuesi në të cilin nuk janë të përfshira funksionet kryesore të kërkuara në specifikimet teknike të paraqitura në DST. Funksionet e papërfshira janë si vijojnë:
  - “Ground fault protection” 50N/51N
  - “Overvoltage and undervoltage protection” (59, 27)
  - “Current Unballance” (46)
  - “Breaker failure protection” (50BF)
- Lidhur me mallrat “Furnizimi mbrojtje back up (mbrojtje mbirrymë)”, OE, si katalog ka paraqitur një dokument konfigurimi i releve lëshuar nga prodhuesi në të cilin nuk janë të përfshira funksionet kryesore të kërkuara në specifikimet teknike të paraqitura në DST. Funksionet e papërfshira janë si vijojnë:
  - “Overvoltage and undervoltage protection” (59, 27)
  - “Breaker failure protection” (50BF)
- Lidhur me mallrat “Furnizimi BCU (rele komandimi dhe kontrolli)” OE si katalog ka paraqitur një dokument konfigurimi i releve lëshuar nga prodhuesi në të cilin nuk janë të përfshira funksionet kryesore të kërkuara në specifikimet teknike të paraqitura në DST. Funksionet e papërfshira janë si vijojnë:
  - Funksionin e sinkroncekut (25) kyçje me sinkronizim
- Lidhur me artikullin “Dare ampermetrike” të ofruar nga OE nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara në DST, sepse referuar Katalogut të prodhuesit Extech, dhe i përshkruar në tabelën e artikujve/mallrave me seri 380947, kjo pajisje nuk ofron rezolucionin dhe saktësinë e kërkuar për matjet si në vijim:
  - Rezolucioni për matje në rrymë AC deri në 30 A, është kërkuar 0.1 mA dhe është ofruar nga ofertuesi 1 mA.

- Rezolucioni për matje në rrymë DC deri në 30 A, është kërkuar 1 mA dhe është ofruar nga ofertuesi 10 mA.
  - Rezolucioni për matje në tension AC është kërkuar 0.1 V, nuk ofrohet nga ofertuesi.
  - Rezolucioni për matje në tension DC është kërkuar 0.1 V, nuk ofrohet nga ofertuesi.
- Lidhur me pajisjen “Furnizim Pajisje testimi tre fazor për testim të mbrojtjeve rele” referuar katalogut të paraqitur nga ofertuesi, pajisja e ofruar nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara sepse:
- Pajisja e testimit e ofruar nga ofertuesi nuk është e pajisur me ekran (display) të integruar siç kërkohet në specifikimet teknike të DST-ve, pra nuk mund të funksionojë pa një pajisje shtese. Në DST është kërkuar një pajisje me të gjitha funksionet dhe një ekran i integruar me ngjyra.
  - Përveç sa me sipër referuar katalogut të ofruar nga ofertuesi nuk jepen informacion mbi matjet e parametrave elektrik që realizon pajisja testuese, konkretisht mungojnë parametrat e:
    - Frekuencës
    - Cosø
    - Kendi fazor
    - Rezistencës
    - Fuqisë
    - Kohës
- Lidhur me “Bay Unit për Mbrojtjen e Zbarave N.St. Babicë” referuar të dhënave të katalogut të ofruar, nuk është i përshtatshëm dhe nuk konfigurohet për mbrojtjen e zbarave ekzistuese 110 kV tip 7SS5220-4AC32-1AA0/EE.
- Bay uniti i ofruar nuk mund të zëvendësojë bay unitin ekzistues, i cili është i tipit 7SS5231-5CA01-0AA1/EE.

Si konkluzion pjesa më e madhe e pajisjeve të ofruara nga OE ofertues, kanë mangësi thelbësore në specifikime teknike janë të papërshtatshme dhe jo funksionale për çfarë janë kërkuar si dhe për një artikull nuk ka as autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar dhe nuk ka paraqitur as katalogje.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar të dhënat e kërkuara për mallrat objekt prokurimi, dhe konkretisht për Aksesorë për analizatorët e gazeve të autotransformatorëve dhe transformatorëve. Mosplotësimi korrekt i tabelës, është element skualifikues.

## **2. OE “LIGUS” sh.p.k., me NIPT L51523001S, për arsye se:**

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i paraqitur nga OE nuk është në përputhje me formatin e formularit të pasqyruar në Dokumentet e Tenderit.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilanceve, të nevojshme për të vërtetuar se të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, si vijon:

1. Furnizim Pajisje testimi tre fazor për testim të mbrojtjeve rele.
2. Aksesorë për analizatorët e gazeve të autotransformatorëve dhe transformatorëve.
3. Bay Unit për Mbrojtjen e Zbarave N.St. Babiçë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “EVOLVE ENGINEERING” sh.p.k., me NIPT M01910016I** Adresa: Tiranë, Rruga “Don Bosko”, Objekt Shërbimi Nr. 7, Nr. pasurie 9/438-N7 & **“EPES GROUP” sh.p.k., me NIPT L22320017F** Adresa: Tiranë, Njesia Administrative Nr. 7, Rruga “Artan Lenja”, Ish fusha e Aviacionit, Kati parë, Pasuria me numër 2/885, Volumi 52, Faqe 68, ZK. 8220, se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **68,456,000 (gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30 (tridhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**ADMINISTRATOR I OST SH.A.**

**Skerdi Drenova**

Konceptoi: N. Troci

Pranoi: T. Qyteza

Miratoi: A. Veliu